



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORJA PËR PUNENE E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Në bazë të nenit 6, dhe 9 të Statutit të Federatës së Hendbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "FHK", në mbledhjen e Bordit të FHK-së me datën 01.10.2022 miraton këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Neni 1

Këshilli Mbikëqyrës kujdeset për punën, ligjshmërinë dhe për veprimtarinë materialo – financiare të FHK-së. Këshilli mbikëqyrës e ka Kryetarin dhe dy anëtarët të cilët zgjidhen nga anëtarësia e FHK-së por jo anëtarë të Kuvendit, por duhet të jenë njohës të sportit për shkak të natyrës së punës. Për punën e Këshillit Mbikëqyrës miratohet rregullore e veçantë. Mandate i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është katër vjet.

Neni 2

Këshilli Mbikëqyrës punon në bazë të parimit të ligjshmërisë, të efikasitetit dhe ekonomicitetit. Mbikëqyrë, shqyrton aktet juridike, vendimet e ndryshme dhe punën materialo – financiare të FHK-së.

Neni 3

Këshilli tre (3) anëtarësh vendosë me shumicë votash për vendimet e tij dhe përpilon raportin me shkrim.

Neni 4

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të bëjë shikimin në vendimet e organeve të FHK-së, në veprimtarinë materialo – financiare si dhe në aktet normative të tjera që i kërkohen nga Këshilli. Shërbimi i FHK-së është i detyruar të paraqet të gjitha dokumentet që i kërkon Këshilli.

Neni 5

Vendimet, raportet dhe aktet tjera të Këshillit Mbikëqyrës ruhen si dokumentacion zyrtar në arkivin e FHK-së.

Neni 6

Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet informon Bordin e FHK-së dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FHK-së.

Neni 7

Anëtarët e Këshillit i zgjedhë dhe i shkarkon Kuvendi i FHK-së.

Neni 8

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrat si vijon:

1. Organizon dhe konvokon mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës
2. Kryeson me mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës
3. Kujdeset për sigurimin e transparencës në punën e Këshillit Mbikëqyrës
4. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara me Rregulloren mbi Punën e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 9

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejt që në seancë të:

1. Propozon shqyrtimin e pyetjeve nga fushëveprimi i punës të Këshillit Mbikëqyrës.
2. Shtron pyetje dhe kërkon sqarimin për çdo pikë të rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës
3. Paraqet propozime lidhur me vendimet, raportet, konkluzionet dhe aktet tjera nga fushëveprimi i punës së Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 10

Këshilli Mbikëqyrës merr vendime dhe konkluzione, me shumicën e votave.

Neni 11

Këshilli Mbikëqyrës merr vendime kur vendosë për ndonjë nga pyetjet nga fushëveprimi i punës së Këshillit Mbikëqyrës. Vendimi sipas rregullës duhet të ketë:

- hyrjen,
- dispozitivin dhe
- arsyetimin.

Neni 12


Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës i konvokon Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, por mbledhjet e Këshillit mund t'i konvokoj edhe Kryetari i FHK, së paku një e treta 2/3 të anëtarëve të Bordit. Rendin e ditës e përcakton konvokuesi i mbledhjes.

Neni 13

Në mbledhje të këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali, i cili duhet të pasqyrojë rrjedhën e mbledhjes dhe vendimet / konkluzionet e aprovuara. Procesverbalin duhet ta nënshkruajnë, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, prezentë.

Neni 14

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë,

01.10.2022.



Eugen Saraçini
President i FHK-së